



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

NJOFTIM PËR QYTETARË

Të dashur qytetarë të Komunës së Mitrovicës Veriore ju njoftojmë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Tatimit në Pronë ka përgaditur faturat e Tatimit në Pronë për vitin Tatimor 2026, të cilat mund ti gjeni në platformën **eKOSOVA** në linkun <https://ekosova.rks-gov.net/> si dhe në zyrën e Tatimit në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Pagesa për tatimin e vlerësuar është ndarë në dy këste, të cilat duhet të paguhen deri më 30 Qershor dhe 30 Shtator. Borxhet duhet të paguhen menjëherë. Nëse pagesa juaj vonohet, ju do të duhet të paguani gjobë dhe interes.

Për të shmangur gjoba dhe interes, është e rëndësishme që të mos paguani më vonë se datat e caktuara për pagesë. Ato zakonisht janë:

- **Menjëherë** – Borxhet
- **30 Qershor** – Kësti i parë
- **30 Shtator** – Kësti i dytë
-

Nëse Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve apo Komunat vendosin të lëshojnë faturën më vonë se 31 Janar, datat për pagesë për këstin e parë do të shtyhen përputhshmërisht. Ju gjithmonë mund të gjeni datat aktuale në faturë.

Nëse data për pagesë bie në fundjavë, afati për pagesë shtyhet deri në ditën e radhës të punës.

Nëse pagesa juaj vonohet, ju do të duhet të paguani:

- Një **gjobë prej 10%** të tatimit të papaguar.
- Një **interes prej 0,65%** të tatimit të papaguar për secilin muaj të vonesës.
-

Ju mund të paguani tatimin tuaj në pronë në një prej mënyrave në vijim:

- Në një bankë të licensuar nga Banka Qëndrore e Kosovës;
- E-banking;

- Në Zyrë Postare apo institucione tjera të licensuara;
- Në komunë për shuma deri në 10 €.

Nëse jetoni jashtë vendit, ju keni alternativa të ndryshme për të paguar tatimin e pronës tuaj. Ju mund të paguani në një prej mënyrave si në vijim.

① Në një bankë lokale komerciale apo institucion tjetër të licensuar në Kosovë

② Paguesa përmes e-banking

③ Paguesa përmes transfereve ndërkombëtare

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj !